

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Këshillin e Integritimit: Forcimi i administratës publike, prioritet për Shqipërinë europiane

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Integritimit European, në sesionin “Avancimi i Shqipërisë në Rrugën Europiane-Reforma, Qëndrueshmëri dhe Rezultate”, ku prezantoi situatën e administrimit të shërbimit civil dhe sfidat kryesore në kuadër të procesit të integritimit europian.



Në fjalën e saj, Komisionerja theksoi rëndësinë e ndërtimit të një administrate publike profesionale, të paanshme dhe të bazuar në meritë, si një nga kushtet themelore për forcimin e shtetit të së drejtës dhe avancimin e reformave europiane.

Ajo nënvizoi se, krahas zhvillimeve pozitive në funksionimin e sistemit të karrierës në administratë, mbeten ende sfida që lidhen me respektimin e procedurave ligjore të punësimit, vakancat dhe forcimin e mekanizmeve të vlerësimit të performancës.

Komisionerja ndaloi gjithashtu tek roli mbikëqyrës i institucionit që drejton dhe amendimet e propozuara në ligjin për nëpunësin civil, duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të kapaciteteve të Institutit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.



Komisioneri riafirmoi angazhimin për të vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe për të kontribuar në forcimin e meritokracisë dhe profesionalizmit në administratën publike shqiptare.

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të Ditës së Europës.

